



SËRISH KA DËSHTUAR KONSTITUIMI I PËRBËRJES SË RE PARLAMENTARE

BLLOKADË INSTITUCIONALE,

SEANCA VAZHDON TË SHTUNËN



Për të dytën herë deputetët kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e re parlamentare nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, i

ftoi në konsultime përfaqësuesit e partive politike. Por, pas konsultimit, ai tha se nuk ka konsensus se si të vazhdohet tutje, duke njoftuar se seanca do

të vazhdojë më 19 prill në orën 12:00. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja e fajësuan LV-në se me ndërprerjen e seancave po tenton “të blejë kohë për pazare politike”

ORGANIZATAT E

DALA NGA LUFTA E

UÇK-së: PECIALJA,

MEKANIZËM

POLITIK, NUK

KA PËR QËLLIM

NDARJEN E

DREJTËSISË, POR

SELEKTIMIN E SAJ

F. 3



KËRKOHET BURGIM I PËRJETSHËM PËR

TË AKUZUARIT PËR SULMIN NË BANJSKË

F. 7



AKTUALE



LIDERË TË LARTË UKRAINAS,

EVROPIANË DHE AMERIKANË

TAKOHEN NË PARIS

F. 2

OVLUÇK-ja KËRKON NGA DEPUTETË

T'I ADRESOJNË PADREJTËSITË NË

PROCESIN GJYQËSOR NDAJ KREKËVE

TË UÇK-së

F. 3

PRESIDENTJA OSMANI: MASAKRA

E POKLEKUT, KUJTËSË QË NUK

SHUHET DHE PLAGË QË

NUK MBYLLET PA DREJTËSI

F. 6

EKONOMI



KMDLNJ: ZRRE E MBYLLI QARKUN

E KRIMIT EKONOMIK

F. 8

GËRXHALIU: DO TË KETË PRAPË

TENTATIVË PËR NGRITJE TË TARIFAVE

TË ENERGJISË ELEKTRIKE

F. 8

SPORT



NUK GABOJNË DRITA DHE

BALLKANI

F. 10

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princsha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030-500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Liderë të lartë ukrainas, evropianë dhe amerikanë takohen në Paris

PARIS, 17 PRILL - Zyrtarë të lartë nga vende të rëndësishme evropiane, Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina, janë mbledhur në Paris të enjten, disa ditë pas bisedimeve të drejtpërdrejta midis Uashingtonit dhe Moskës, të cilat synojnë t'i japin fund luftës midis Rusisë dhe Ukrainës. Lufta në Ukrainë, të cilën Moska e nisi më 2022, është më e madhja në Evropë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Kjo është hera e parë që do të zhvillohen takime ballë për ballë midis liderëve të lartë evropianë dhe ukrainas dhe të dërguarit të posaçëm amerikan, Steve Witkoff, pas takimit të tij më të fundit me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, javën e kaluar. Moska nuk ka pranuar ta nënshkruajë një marrëveshje të gjerë armëpushimi, e cila u propozua nga presidenti amerikan Donald Trump. Ukraina e ka pranuar atë tashmë. Rusia ka thënë se çdo marrëveshje është e kushtëzuar me ndalimin e përpjekjeve për mobilizim nga Kiev, si dhe me ndërprerjen e furnizimit të Ukrainës me armë nga Perëndimi. Këto kërkesa janë hedhur poshtë nga Ukraina. Megjithatë, Witkoff tha së fundmi për "Fox News" se beson që një marrëveshje për paqe është "duke ndodhur". Ai tha se ka dëgjuar "cilat janë kërkesat e

Putinit për një paqe të përhershme këtu", duke shtuar se bëhej fjalë "për të ashtuquajturat pesë territore". Kjo i referohet pjesëve të Ukrainës të pushtuara pjesërisht nga Rusia. Derisa bisedimet filluan, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se teksa Uashingtoni po punon për paqen, "nga evropianët ne shohim një përqendrim në vazhdimin e luftës". Ndërkohë, Rusia nuk i ka ndaluar sulmet vdekjeprurëse me raketa mbi qytetet ukrainase ditët e fundit. Më 16 prill, një sulm me dronë rusë në qytetin Dnipro vrau të paktën pesë njerëz. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u bëri thirrje pjesëmarrësve në bisedimet në Paris që të ushtrojnë tryzni ndaj Rusisë për ta pranuar armëpushimin. "Rusia e përdor çdo ditë dhe çdo natë për të vrarë. Ne duhet të ushtrojmë tryzni mbi vrasësit... për ta përfunduar këtë luftë dhe për të garantuar paqe të qëndrueshme", tha Zelensky në një postim në Telegram. Përveç Witkoffit, në bisedime do të marrin pjesë edhe sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, dhe i dërguari i presidentit ukrainas, Andriy Yermak. Këshilltari për Sigurinë Kombëtare



i Britanisë, Jonathan Powell, dhe Jens Ploetner, këshilltar i lartë i kancelarit gjerman Olaf Scholz, mbajtën takim paraprakisht me Witkoffin në Pallatin Elize. Para bisedimeve në Paris, analisti politik Anton Penkovsky tha për Current Time të Radios Evropa e Lirë se nuk priste vendime të mëdha. "Mendoj se mund të presim disa çështje teknike, disa vendime lidhur me armëpushimet 30-ditor, që janë shpallur tashmë

dhe që lidhen me Detin e Zi dhe infrastrukturën energetike, të cilat nuk janë respektuar. Mendoj se mund të kemi lajme për zgjatjen e tyre", tha ai. Në prag të mbërritjes së Rubios të enjten, Departamenti amerikan i Shtetit deklaroi se qëllimi i bisedimeve ishte "ta çojnë përpara synimin e presidentit Trump për t'i dhënë fund luftës Rusi-Ukrainë dhe për të ndaluar gjakderdhjen". Yermak shkroi, pasi mbërriti në

Paris: "po punojmë për çështje të rëndësishme për sigurinë e Ukrainës dhe të gjithë Evropës". Ndërsa Uashingtoni është përpjekur t'i shtyjë përpara bisedimet për armëpushim midis Kievit dhe Moskës, vendet evropiane janë fokusuar në mbështetjen e Ukrainës dhe në planifikimin e një misioni të mundshëm ushtarak për ta forcuar çfarëdo marrëveshje armëpushimi.

Mianmari liron rreth 4 900 persona, përfshirë të burgosur politikë

JANGON, 17 PRILL - Kreu i Qeverisë ushtarake të Mianmarit ka amnistuar afër 4 900 të burgosur. Amnistia u lëshua në ditën kur ky shtet shënon Vitin e Ri tradicional, raportoi medie shtetërore. Një organizatë e pavarur tha se në mesin e të liruarve janë të pakën 22 të burgosur politikë. Të paktën 19 autobusë me të burgosur u larguan nga burgu Insein në Jangon dhe familjarët dolën te porta e burgut për të pritur të afërmit e tyre mëngjesin e 17 prillit. Rrjeti i Mianmarit për të Burgosur Politikë, një grup i pavarur vëzhgues që regjistron



shkeljet e të drejtave të njeriut në burgjet e Mianmarit, tha përmes një deklaratë se sipas informatave fillestare, të paktën 22 të burgosur politikë janë liruar. Gjenerali Min Aung Hlaing, kreu i Këshillit Ushtarak që udhëheq me shteti, fali 4.893 të burgosur, raportoi MRTV. Trembëdhjetë të huaj po ashtu u liruan dhe u dëbuan nga Mianmari, raportoi media shtetërore. Të burgosurit e tjerë morën ulje dënimi, përveç atyre që janë të dënuar për akuza të rënda si vrasje dhe përdhunim, apo të atyre që janë të dënuar për çështje të sigurisë.

Nëse të liruarit shkelin përsëri ligjin, ata do të duhet të vuajnë pjesën e mbetur të dënimit origjinal, përveç çdo dënimi të ri. Amnistitë masive gjatë festave nuk janë të pazakonshme në Mianmar, shtet që njëherë më herët si Burma. Mianmari udhëhiqet nga junta ushtarake që nga 1 shkurti i vitit 2021, kur ushtria rrëzoi qeverinë e zgjedhur, të udhëhequr nga udhëheqësja civile, Aung San Suu Kyi. Marrja e pushtetit nga ushtria, nxiti rezistencë masive paqësore, e cila më vonë u shndërrua në një luftë të armatosur. Vendi tani përballet me luftë civile.

Për herë të parë në histori republika çeke, e pavarur nga nafta ruse

PRAGË, 17 PRILL - Republika Çeke është e pavarur nga nafta ruse për herë të parë në historinë e saj, ka njoftuar kryeministri i vendit. Praga tani po merr furnizime

alternative me karburant falë zgjerimit të gazsjellësit perëndimor Transalpin, i cili kalon nëpër Itali, Austri dhe Gjermani. Masa nënvizon përpjekjet

evropiane për t'i dhënë fund varësisë nga nafta dhe gazi rus në përgjigje të pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Moska në vitin 2022. "Për herë të parë në histori,

Republika Çeke furnizohet plotësisht nga nafta jo-ruse dhe furnizohet plotësisht përmes rrugëve perëndimore", tha Petr Fiala, kryeministri i Republikës Çeke.



ORGANIZATAT E DALA NGA LUFTA E UÇK-së: SPECIALJA, MEKANIZËM POLITIK, NUK KA PËR QËLLIM NDARJEN E DREJTËSISË, POR SELEKTIMIN E SAJ

Organizatata e dala nga lufta, OVL UÇK, SHIL UÇK, SHFD UÇK, kanë reaguar lidhur me aktakuzën e ndryshuar ndaj Hashim Thaçit dhe bashkëluftëtarëve të tjerë. Këto organizata të dala nga lufta kanë theksuar se ky veprim dëshmon qartë vazhdimin e një qasjeje të padrejtë dhe të njëanshme ndaj figurave kryesore të luftës çlirimtare dhe shtetformuese të Kosovës. “Është më se e qartë se Gjykata Speciale, që nga themelimi i saj, ka funksionuar si një mekanizëm politik, i cili nuk ka për qëllim ndarjen e drejtësisë, por selektimin e saj”, është thënë në reagimin e organizatave të luftës së UÇK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 PRILL - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së në një reagim publik ka thënë se me shqetësim të thellë ka ndjekur lajmin për dorëzimin e një aktakuze të ndryshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ndaj Hashim Thaçi dhe bashkëluftëtarëve të tjerë, ku pretendohet për një formë të re të përgjegjësisë penale, kinse për “shtytje” në pengimin e personave zyrtarë.

Në reagim thuhet se ky veprim dëshmon qartë vazhdimin e një qasjeje të padrejtë dhe të njëanshme ndaj figurave kryesore të luftës çlirimtare dhe shtetformuese të Kosovës. “Përfshirja e Thaçit në një çështje që nuk ka asnjë lidhje me akuzat e mëparshme për të cilat po mbahet në paraburgim, është tregues se synimi nuk është drejtësia, por zgjatja e procesit dhe njollosja e qëllimshme e figurave që përfaqësojnë simbolin e rezistencës dhe lirisë së popullit tonë”, thuhet në



reagim. Më tutje, theksohet se “është më se e qartë se Gjykata Speciale që nga themelimi i saj ka funksionuar si një mekanizëm politik, i cili nuk ka për qëllim ndarjen e drejtësisë, por selektimin e saj”. “Kjo gjykatë është shndërruar në një instrument të padrejtësisë ndërkombëtare, ku veprimet e saj janë shpesh të motivuara politikisht dhe në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës penale. Është e papranueshme që në emër të drejtësisë të përdoren metoda

që duken më shumë si mjete presioni sesa si standarde ligjore të një gjykate ndërkombëtare. Tentimi për ta ngarkuar Thaçin me përgjegjësi për vizita të lejuara nga vetë autoritetet, gjatë kohës sa ishte në paraburgim, është i pabazë dhe politikisht i motivuar”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. OVLUÇK ka ftuar opinionin publik, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, që të reflektojnë mbi këtë qasje selektive dhe të ndalojnë një proces që po përdoret për ta

rishkruar historinë dhe për ta njollosur luftën e drejtë të UÇK-së.

Në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dorëzuar aktakuzën e ndryshuar që parasheh shtimin e një forme përgjegjësie për Thaçin. Kjo u bë e ditur nga Prokuroria përmes një parashtrimit të 16 prillit 2025, e cila tregoi se ndryshimet janë bërë në paragrafin 43 dhe 46, përkatësisht pikat e akuzës 1, 2 dhe 3, ka raportuar “Betimi për Drejtësi”.

Më 14 prill 2025 gjyqtarja e procedurës paraprake, Marjorie Masselot, ka ndryshuar vendimin e mëparshëm për konfirmimin e aktakuzës, kështu duke konfirmuar formën e përgjegjësisë penale për Thaçin që bie në bazë të nenit 32 (3) të KPRK-së që ka të bëjë për shtytje në kryerjen e veprës penale të “Pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare”, në bazë të nenit 401 (3) dhe (5) të KPK-së.

OVLUÇK-ja KËRKON NGA DEPUTETË T’I ADRESOJNË PADREJTËSITË NË PROCESIN GJYQËSOR NDAJ KRERËVE TË UÇK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 PRILL - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka dalë të enjten para Kuvendit të Kosovës pak para vazhimit të seancës konstituive. Ajo ka kërkuar nga deputetët e zgjedhur t’i adresojnë “padrejtësitë në procesin gjyqësor kundër krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë”. Ata u kanë dhënë deputetëve të zgjedhur nga një letër në të cilën është shkruar “Betimi për drejtësi”. OVLUÇK-ja kërkoi ta të betohen për t’u angazhuar në



mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së. Nga deputetët e zgjedhur është kërkuar krijimi i një mekanizmi

mbikëqyrës ndaj Speciales. Ish-drejtuesi i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Nasim Haradinaj, ka thënë se



qëllimi i kësaj letrë është t’u kërkohet deputetëve ta nënshkruajnë atë me qëllim të reagojnë për padrejtësitë

në gjykimin në Hagë. Sipas tij, tani edhe Shtetet e Bashkuara kanë ndryshuar qëndrim ndaj Gjykatës Speciale dhe se ka ardhur koha ta bëjë të njëjtën edhe Kosova. “Shpresojmë që deputetët do ta nënshkruajnë këtë betim simbolik si një zotim moral për t’i adresuar padrejtësitë ndaj krerëve të UÇK-së dhe ushtarëve të tjerë që po gjykohen padrejtësisht në Hagë. Tani që edhe Shtetet e Bashkuara kanë ndryshuar qëndrim ndaj Gjykatës Speciale, ka ardhur koha ta bëjë të njëjtën edhe Kosova”, ka thënë Nasim Haradinaj.

Arrestohet Dardan Molliqaj, PSD-ja kërkon lirimin e tij

PRISHTINË, 17 PRILL - Njësia e reagimit të Shpejtë e Policisë së Kosovës ka arrestuar të enjten kryetarin e PSD-së, Dardan Molliqaj, teksa ishte rrugës për një takim. Kështu kanë shkruar në rrjetin social në “Facebook” nga Partia Socialdemokrate (PSD). “Ky arrestim është totalisht jashtë çdo racionaliteti. Përderisa nuk ka marrë as ftesë nga gjykata dhe në të njëjtën kohë

çdo ditë është në rutinën e tij dhe mund të gjendet lehtësisht, kjo sjellje nuk mund të lexohet ndryshe përveç se presion politik dhe demonstrim force nga një njësi e krijuar për situata emergjente dhe të rrezikshme, jo për të ndaluar opozitën politike. Prioriteti dhe zelli në të cilin janë vendosur anëtarët e PSD-së për ‘shqyrtim rastesh; lë dyshime se kjo po

ndodhë qëllimshëm, meqë një numër të madh rastesh e kanë së bashku me anëtarët e VV-së, duket që mësyryja është kryesisht ndaj PSD-së. Arrestime të tilla nuk na ndalin, vetëm e bëjnë më të qartë për të gjithë kush ka frikë nga organizimi politik. Kërkojmë lirimin e menjëhershëm të Dardan Molliqajt”, është thënë në njoftimin e PSD-së.





SËRISH KA DËSHTUAR KONSTITUIMI I PËRBËRJES SË RE PARLAMENTARE

BLLOKADË INSTITUCIONALE, SEANCA VAZHDON TË SHTUNËN

Për të dytën herë deputetët kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e re parlamentare nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, i ftoi në konsultime përfaqësuesit e partive politike. Por, pas konsultimit, ai tha se nuk ka konsensus se si të vazhdohet tutje, duke njoftuar se seanca do të vazhdojë më 19 prill në orën 12:00. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja e fajësuan LV-në se me ndërprerjen e seancave po tenton “të blejë kohë për pazare politike”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 17 prill - Për të dytën herë deputetët kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e re parlamentare nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, i ftoi të enjten në konsultime përfaqësuesit e partive politike por, pas konsultimit, ai tha se nuk ka konsensus se si të vazhdohet tutje, duke njoftuar se seanca do të vazhdojë më 19 prill në orën 12:00. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja fajësuan LV-në se me ndërprerjen e seancave po tenton “të blejë kohë për pazare politike” pasi, sipas tyre, partia e Albin Kurtit

nuk i ka votat për ta zgjedhur kryeparlamentarin e as qeverinë. Këto parti insistojnë që anëtarët e kabinetit qeverisës, që kanë dhënë dorëheqje me qëllim që të betohen si deputetë, nuk mund ta vazhdojnë punën në ekzekutiv. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, e ka cilësuar të pakuptimtë kërkesën për dorëheqje, pasi argumentoi se qeveria e tij është në dorëheqje që nga 23 marsi. Deputetja e zgjedhur në listën e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka drejtuar kritika për PDK-në, LDK-në dhe AAK-në, të cilat tha se janë përgjegjëse për bllokimin e formimit të institucioneve të reja.

Kusari-Lila tha se në rast se vazhdon dështimi i konstituimit të Kuvendit duhet parë opsione të tjera, përfshirë ftesën për partitë politike për të diskutuar për veprimet e ardhshme. Ajo e quajti të pakuptimtë se si partitë që ishin në opozitë mandatin e kaluar ‘po hezitojnë’ të marrin mandatet që fituan në zgjedhjet e 9 shkurtit. Albulena Haxhiu nga LV-ja ka thënë se partia e saj dëshiron të gjejë zgjidhje për situatën e krijuar në Kuvend. Ajo ka thënë se edhe presidentja Osmani u ka kërkuar deputetëve të gjejnë zgjidhje dhe, për këtë, sipas saj, “duhen konsultime”. “Ne duam ta korrigjojmë vendimin e gabuar të

Kuvendit, por duhet të shohim se si është mënyra për ta korrigjuar atë vendim”, ka thënë ajo duke iu referuar mosmiratimit të raportit të Komisionit për verifikimin e mandateve. “Kemi vullnet që të propozojmë mënyra se si duhet shkuar tutje. A do të jetë një komision i ri apo komisioni paraprak ta bëjë përgatitjen e raportit të ri. Mund të ketë dhe propozime të tjera”, ka deklaruar Haxhiu pas ndërprerjes së seancës konstituive. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se LV-ja nuk ka shumicë dhe nuk është “as afër” arritjes së shumicës prandaj, sipas tij, po pengon mbarëvajtjen e seancës konstituive për të blerë “kohë për pazare politike”. “Skenari ka qenë i qartë, e vetmja punë që ka pasur ai [kryesuesi i seancës Avni Dehari] është që të hidhte në votim raportin e Komisionit për Verifikimin e Mandatave dhe Kuroumit”, është shprehur Krasniqi. Sipas Krasniqit, përmes kryesuesit Dehari, LV-ja po

mban peng formimin e institucioneve të Kosovës. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, e ka quajtur të padrejtë ndërprerjen e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës. Abdixhiku e quajti shkelje të rëndë dhe “praktikë të mbrapshtë” vendimin e kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, për ndërprerje të seancës konstituive. Abdixhiku tha se Dehari që, sipas tij, ka rastisur të jetë nga Lëvizja Vetëvendosje, veptoi padrejtësisht pasi, sipas tij, kishte kuorum për të vazhduar votimin e raportit të Komisionit për Verifikim të Mandateve dhe Kuromit. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se politikat bllokuese, shantazhuese dhe uzurpuese janë kryefjala e Albin Kurtit. “Pezullimi i seancës në mënyrë arbitrare, edhe pse ishin numrat për vazhdim, e shfaq edhe një herë qartë se kush janë këta njerëz që e mbajnë peng Kosovën tash e

më shumë se katër vjet. Kosova dhe karakteri i saj parlamentar, demokratik dhe properëndimor nuk do të rrëshqasin për shkak të tekeve dhe dëshirave autokratike e diktatoriale të lindjes. Është fare e thjeshtë: Dorëhiqu - nuk mund t'i kesh dy pozita. Propozojeni dhe formojeni kryesinë e Kuvendit. Formo qeverinë. Nëse nuk mundesh, ik, lësho rrugë. Përndryshe, pushtetin do t'ia kthejmë sovranit - e aty mashat do të digjen”, ka thënë Haradinaj.

KDI: Dorëheqjet formale të anëtarëve të qeverisë do ta zhbloktonin konstituimin e Kuvendit

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka shprehur shqetësim të thellë për dështimin e përsëritur të Kuvendit për ta miratuar raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve, një ndër hapat e domosdoshëm drejt konstituimit të Kuvendit dhe fillimit të punës së legjislaturës së re. Sipas KDI-së, mosdorëheqja formale e kryeministrit dhe ministrave të cilët janë zgjedhur deputetë, përveçse shkelje e qartë e parimeve të ndarjes së pushteteve, po pamundëson votimin e raportit, duke cenuar drejtpërdrejt funksionalitetin institucional të

Kuvendit. “KDI rikujton se sipas legjislationit në fuqi, anëtarët e ekzekutivit duhet të japin dorëheqje, madje qysh para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Po ashtu, edhe dispozitat kushtetuese ndalojnë ushtrimin e funksioneve të papajtueshme me mandatin e deputetit. Mosrespektimi i këtyre dispozitave nuk është çështje teknike apo e interpretimeve procedurale, por një shkelje e qartë e normave që rregullojnë ushtrimin e funksioneve publike në një rend demokratik”, është thënë në reagimin e KDI-së. Gjithashtu, KDI-ja vlerëson se mbyllja e seancës konstituive të enjten nga ana e kryesuesit të saj, deputetit Avni Dehari, përbën shkelje të rregullores dhe praktikës parlamentare, pasi ajo u ndërpre pa u realizuar votimi për raportin nga Komisioni i Përkohshëm dhe pa u konsumuar asnjë nga pikat e rendit të ditës. “Një veprim i tillë, që anashkalon procedurat pa vendim formal të Kuvendit, cenon seriozisht legjitimitetin e procesit dhe i shton më tej paqartësitë rreth funksionimit të seancës. Fakti që Kuvendi nuk po arrin t'i verifikojë mandatet për shkak të këtij ngërçi të krijuar nga mungesa e dorëheqjeve formale, tregon për një mungesë të vullnetit për ta respektuar ligjin dhe


për ta lejuar funksionimin normal të institucioneve. Ky veprim, apo më saktë mosveprim nga ana e anëtarëve të qeverisë në detyrë, po e kthen një procedurë standarde dhe të thjeshtë - në një krizë të panevojshme politike dhe institucionale”, është theksuar në reagimin e KDI-së. KDI u ka bërë thirrje kryeministrit dhe ministrave në detyrë, që kanë fituar mandate si deputetë, ta respektojnë detyrimin e qartë ligjor për dorëheqje formale nga pozitat ekzekutive, në mënyrë që të mundësohet përfundimi i seancës konstituive të Kuvendit. “Institucionet nuk mund të konstituohen duke anashkaluar ligjin. Çdo zvarritje e mëtejshme është papërgjegjësi politike dhe cenon besimin e qytetarëve në procesin demokratik”, është thënë në reagimin e KDI-së.

Analistët politikë: Bllokada institucionale, shpërfillje e vullnetit të qytetarëve

Dështimin e sërishëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për ta vazhduar procesin e konstituimit të legjislativit, Artan Muhaxhiri, profesor i sociologjisë dhe njohës i

zhvillimeve politike, e cilësoi situatë për keqardhje. Ai thekson se politikanët janë duke u sjellë në mënyrë të papërgjegjshme ndaj qytetarëve që ua kanë besuar votat dhe, sipas tij, sjellja e tyre është irrituese dhe zhgënjyese. “Nuk ka aspak vullnet për bashkëpunim dhe për gjetje të zgjidhjes. Sipas të gjitha gjasave, mundësia e vetme [për të tejkaluar ngecjen] është t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, sepse ajo, si instanca e fundit, mund ta marrë një verdikt për zhblokimin e gjendjes aktuale”, thotë Muhaxhiri për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shton se ngecja në konstituimin e Kuvendit po bëhet qëllimshëm nga partitë politike, sepse me konstituimin e legjislativit do të hapej rruga për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Në këtë kontekst, sipas tij, as Lëvizja Vetëvendosje, si parti fituese, por as tri partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike të Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk kanë motiv të mjaftueshëm për ta tejkaluar bllokadën për konstituimin e Kuvendit. “Sikur të ishte e kundërta, kjo punë tashmë do të përfundonte... Jemi në një qorrrokak, sepse [kreu i LV-

së, Albin] Kurti nuk dëshiron ta krijojë qeverinë ndërsa, në anën tjetër, opozita nuk i ka votat, në të kundërtën edhe ajo do të duhej të ishte më energjike për kërkimin e zgjidhjeve ligjore për të dalë nga kjo bllokadë”, thekson Muhaxhiri. Sipas tij, hedhja e fajit për ngecjen e procesit të konstituimit të Kuvendit ndërmjet partive politike, Lëvizjes Vetëvendosje në njërin anë dhe të PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, është vetëm luajtje e “rolit të viktimave” para qytetarëve të vendit. Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) tha se dështimi për ta konstituuar Kuvendin, edhe pas vazhimit të seancës konstituive më 17 prill, përbën një shkelje të qartë të vullnetit qytetar të shprehur përmes votës më 9 shkurt. “Mosfunktionalizimi i Kuvendit pamundëson formimin e qeverisë së re, duke ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin institucional dhe në rrjedhën demokratike të shtetit”, theksoi Jakaj për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shtoi se qytetarët kanë votuar për ndryshim, përfaqësim të denjë dhe për institucione funksionale. Sipas tij, çdo vonesë në këtë drejtim përbën shpërfillje të vullnetit të tyre dhe pengesë serioze për zhvillimin demokratik dhe institucional të vendit.



Presidentja Osmani: Masakra e Poklekut, kujtesë që nuk shuhet dhe plagë që nuk mbyllet pa drejtësi

PRISHTINË, 17 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani ka kujtuar masakrën e Poklekut, për të cilën ka thënë se është një kujtesë që nuk shuhet. “Në mesin e 54 të vrarëve në Poklek, 24 ishin fëmijë nga moshë gjashtë muaj e deri në 17 vjeç. Ata u vranë mizorisht e pastaj u dogjën nga forca të regjimit gjenocidal serb, synim i të cilëve ishte shfarosja. Në mesin e viktimave, ishte edhe Liria, një

foshnjë vetëm 6 muajshe, që mbante emrin e një ideali që ende nuk e kishte jetuar. Ajo nuk e gëzoi kurrë lirinë. Por emri i saj mbetet amanet për secilin prej nesh. Të tillë mbeten edhe emrat e 23 të vrarëve në Çikatovë të Vjetër”, ka thënë Osmani, duke shtuar se sot nuk mjafton vetëm t’i kujtojmë. “E kemi obligim të kërkojmë drejtësi. Jo vetëm për Lirinë, por për çdo fëmijë të vrarë, për çdo familje të

shuar. Drejtësia nuk është hakmarrje. Është premtimi më minimal që ia kemi borxh viktimave. Është përgjegjësia jonë që ky krim të mos mbulohet nga pluhuri i harresës apo nga heshtja. Të mos ndalemi derisa drejtësia të triumfojë. Sepse pa të, pa të vërtetën e thënë dhe të njohur, pa përgjegjësi për krimet, nuk ka paqe të qëndrueshme”, ka theksuar Osmani.



POLICIA NË VERI SËRISH GJEN ARMË DHE MUNICION



MITROVICË, 17 PRILL - Pas pranimit të një informate nga qytetarët mbi dyshimet se në një lokacion ka armë, njësitet policore kanë ndërmarrë veprimet e menjëhershme, ku kanë kryer një kontroll në bodrumin e një ndërtese kolektive në rrugën “Ivo Lola Ribar” – Mitrovicë Veri. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante të Policisë së Kosovës, të cilat kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për tërheqjen dhe sigurimin e materialit të dyshuar në mënyrë të sigurt. Gjatë kontrollit të realizuar në atë lokacion policia ka gjetur dhe konfiskuar: 8 karikatorë me fishekë, 1

tromblon, si dhe disa pajisje shtesë për montim në armë të destinuara për gjuajtje me tromblon. Policia e Kosovës ka intervistuar një person në cilësi të dëshmitari, ka kontaktuar prokurorin e shtetit dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rastit dhe identifikimin e personave përgjegjës. Rreth rastit nuk ka person të arrestuar. Duke i falënderuar qytetarët për bashkëpunimin, policia ka theksuar se vazhdon të mbetet e përkushtuar për luftim të dukurive negative dhe ofrim të sigurisë për të gjithë qytetarët pa dallim.

RAMA TAKON AMBASADORIN E RI TË JAPONISË, DISKUTOJNË PËR PROJEKTE TË PËRBASHKËTA PËR KRYEQYTETIN

PRISHTINË, 17 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e ri të Japonisë në Kosovë, Kiminori Iwama. Ai ka treguar se kanë biseduar për bashkëpunimet e mundshme në fusha me interes të përbashkët dhe kanë ndarë vlera të përbashkëta për të na afruar si popuj. “Gjithashtu,

mirëprita edhe z. Hiroyasu Tanigaki, të ngarkuarin e ri me punë në Prishtinë, të cilit i urova mirëseardhje dhe suksese në detyrë. Besoj në fuqinë e dialogut dhe mirëkuptimit, dhe mirëpresim bashkëpunim të frytshëm dhe afatgjatë mes kryeqytetit dhe Ambasadës së Japonisë”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Ramosaj nënshkruan kontratën me “Lika Trade” për asfaltimin e rrugëve në fshatrat e Deçanit

DEÇAN, 17 PRILL - Kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka njoftuar të enjten se ka nënshkruar kontratën me kompaninë “Lika Trade” për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në fshatrat e komunës së Deçanit -

Lloti 4”. Ramosaj ka thënë se ky është një hap tjetër konkret drejt përmirësimit të kushteve të jetesës për banorët e Deçanit. “Me këtë projekt do të asfaltohen segmente të rëndësishme rrugore që

ndikojnë drejtpërdrejt në lehtësimin e lëvizjes dhe rritjen e sigurisë në zonat rurale. Me këtë projekt përfundohet me sukses asfaltimi i të gjitha rrugëve dhe rrugicave në fshatrat dhe lagjet e Deçanit”, ka thënë Ramosaj.



KËRKOHET BURGIM I PËRJETSHËM PËR TË AKUZUARIT PËR SULMIN NË BANJSKË



Prishtinë, 17 prill - Në seancën e parë për rastin e sulmit në Banjskë - të enjten në Gjykatën Themelore të Prishtinës - avokati i familjes së rreshterit Afrim Bunjaku që mbeti i vrarë në atë sulm, Arianit Koci, kërkoi burgim të përjetshëm për të akuzuarit. Në fillim të seancës, të akuzuarit Vlladimir Tolliq, Bllagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviq u deklaruan të pafajshëm për akuzat për terrorizëm, financim të terrorizmit dhe vepra të rënda penale.

Tolliqi dhe Spasojeviqi kishin refuzuar të deklarohen për fajësinë në seancën përgatitore të 9 tetorit të vitit të kaluar. Tre të akuzuarit u arrestuan pas sulmit në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023, kur një grup i armatosur i serbëve e sulmoi Policinë e Kosovës dhe vrau policin Afrim Bunjaku. Në shkëmbimin e zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulumues.

Përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjskë e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe – partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që ka përkrahjen e Beogradit zyrtar.

Besohet se ai dhe shumica e pjesëtarëve të grupit të armatosur ndodhen të lirë në Serbi. Për 42 të akuzuarit e tjerë të këtij rasti, që ndodhen në arrati, është kërkuar gjykim në mungesë. Për ta u lëshuan fletarrestime ndërkombëtare nga Gjykata Themelore në Prishtinë me qëllim për t'i sjellë para gjykatës.

Në rastet e gjykimit në mungesë, që janë mundësuar në Kosovë me ndryshimet ligjore të vitit 2022, kërkohet të

shterohen të gjitha opsionet për ta siguruar praninë e të akuzuarve. Në rastet e tjera të këtij lloji, Kosova u ka kërkuar autoriteteve në Serbi t’ua dërgojnë ftesën për marrje në pyetje të akuzuarve dhe rasti i gjykimit ka vazhduar vetëm pasi nuk është marrë përgjigje nga të akuzuarit.

Në seancën e së enjtes, pas deklarimit për fajësinë nga të akuzuarit, prokurori special Naim Abazi tha se përmes videove do të dëshmohej se sulmi ishte i paraplanifikuar dhe se grupi ishte “i mirorganizuar”.

Gjatë shfaqjes së videove të marra nga dronët në ditën e sulmit, Abazi tha se nga sulmi kishin mbetur të dëmtuara edhe shtëpitë e qytetarëve të asaj zone.

Për Tolliqin, i cili ishte gjetur i plagosur, u tha se ishte kapur me armë ushtarake, ndërsa për Spasojeviqin dhe Maksimoviqin u treguan fotografi me të akuzuar të tjerë të këtij rasti.

Në fjalën hyrëse, të akuzuarit Spasojeviq dhe Tolliq thanë se “nuk e kanë sulmuar apo vrarë askënd”.

Spasojeviqi tha se nuk ka synuar bashkimin e veriut të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, me Serbinë, ndërsa Tolliq tha se ai ka qenë në Banjskë më 24 shtator, por “për arsye tjetër” nga ajo që thuhet në aktakuzë.

Avokatët e tre të akuzuarve - Lubomir Pantoviq që mbron Spasojeviqin, Millosh Deleviq që mbron Tolliqin dhe Jovana Filipoviq që mbron Maksimoviqin - thanë se aktakuza “nuk i plotëson kriteret” e Kodit të Procedurës Penale. Ata pretenduan se

Çfarë kanë thënë tre të akuzuarit?

Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës, njëri prej tre të akuzuarve që gjenden në paraburgim në Kosovë është mbrojtur në heshtje.

Një tjetër ka deklaruar në Stacionin policor të Mitrovicës më 24 shtator, 2023, se një ditë më herët ka shkuar në Rashkë, ku është takuar me tre persona (po ashtu të akuzuar), me të cilët, në mënyrë të organizuar me disa vetura, kanë shkuar në Banjskë, ku u janë dhënë uniforma dhe armatim.

Atij i është thënë se “do të bëhet një barrikadë me kamion dhe një protestë, për të cilën ka menduar se është paqësore”. “Por, pasi ka pranuar uniformën ushtarake-taktike dhe armatimin, aty e ka

kuptuar se diçka nuk është në rregull, por se është detyruar t’u bindet urdhrave”, thuhet në aktakuzë.

Sipas aktakuzës, ai ka thënë se gjatë natës ka qëndruar në një veturë dhe pastaj në afërsi të një ujëvare dhe në mal, dhe se “asnjëherë nuk ka shtënë me armë”.

Më vonë, ai i është dorëzuar Policisë së Kosovës.

Ai, po ashtu, ka deklaruar se rreth dhjetë vetura të tipit Jeep pa targa, kanë ardhur nga Serbia me rreth 50 persona, shumicën e të cilëve ka thënë se nuk i ka njohur. “Gjithashtu, ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë presion apo kërcënim për të marrë pjesë në këtë grup dhe se vullnetarisht është bërë pjesë e tij...”.

Çfarë përmban aktakuza?

Prokuroria Speciale e Kosovës, përveç të tjerash, i ngarkon të akuzuarit në rastin Banjska me vepra terroriste dhe vepra kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës.

Prokurori i rastit, Naim Abazi, më herët ka deklaruar se të akuzuarit kanë pasur role të ndryshme brenda grupit kriminal, “nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste, deri të financimi dhe pastrimi i parave”.

Në aktakuzë thuhet se ky grup,

përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, ka tentuar “ta shkëpusë pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe, dhe këtë pjesë të territorit t’ia bashkojë Republikës së Serbisë”.

Si lider i këtij grupi është identifikuar Millan Radoiçiq, për të cilin thuhet se ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e sulmit dhe aktivitetet kriminale.

Radoiçiq gjendet në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar për lidhjet me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin.

Në Kosovë, ai gjithashtu lidhet me vrasjen e një politikani opozitar serb, si dhe me frikësimin e dëshmitarëve në një proces gjyqësor për disa ndërtime ilegale.

Në aktakuzë, Prokuroria përmend 34 dosje me prova, në mesin e të cilave ka video-incizime, analiza të pajisjeve elektronike, përgjigje të ndryshme nga Luksemburgu, Bosnjë-Hercegovina, bankat dhe institucione të ndryshme, deklarata të dëshmitarëve etj.

Autoritetet e Kosovës e cilësojnë sulmin në Banjskë si akt terrorist dhe akuzojnë Serbinë se qëndron pas tij.

Nga ana tjetër, Serbia ka mohuar çdo përfshirje në sulmin në Banjskë, ndërsa presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka theksuar se për Beogradin ky sulm nuk është terrorist, por se po hetohet.

Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar ashpër sulmin në Banjskë dhe ka kërkuar që përgjegjësit të dalin para drejtësisë. (rel)

Auditorët e ZKA-së përfundojnë me sukses programin “LOTA Pioneers”

PRISHTINË, 17 PRILL - Drejtori i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), Samir Zymberi, dhe auditorja seniore për Teknologji të Informacionit, Poliksena Berisha, kanë përfunduar me sukses programin dyvjeçar “Pionierët

përmes Avancimit të Teknologjisë (LOTA Pioneers)” të organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t. Programi LOTA Pioneers synon të zhvillojë agentë ndryshimi brenda Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), për t'i ndihmuar në përdorimin e teknologjisë në auditim dhe në

vlërësimin e mënyrës se si qeveritë aplikojnë teknologjinë në ofrimin e shërbimeve publike. Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka përgëzuar Zymberin dhe Berishën për përfundimin me sukses të këtij programi të rëndësishëm profesional dhe për rolin e tyre udhëheqës në

zhvillimin e planeve strategjike dhe realizimin e auditimeve në fushën e teknologjisë së informacionit. Pjesëmarrja dhe angazhimi i auditorëve të ZKA-së në “LOTA Pioneers” pasqyron përkushtimin e ZKA-së për ta avancuar më tej qasjen teknologjike në auditim dhe për



të ndërtuar ekipe profesionale që udhëheqin njohuri të avancuara në këtë fushë.

GËRXXHALIU: DO TË KETË PRAPË TENTATIVË PËR NGRITJE TË TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

PRISHTINË, 17 PRILL - Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka folur rreth efekteve ekonomike dhe sociale që mund t'i ketë vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) për ngritje të tarifave të energjisë prej 16.1-përqindësh. Ai ka thënë se pas kësaj ngritje të çmimit në një periudhë kohore do të ketë prapë tentativë për ngritje të tarifave nga ana e ZRrE-së. Gërxhaliu ka thënë se nuk ka kurrfarë lobimi kohën e fundit që të shtohet prodhimi i energjisë. “Derisa do të jesh i varur nga importi, definitivisht do të ketë oscilime të energjisë elektrike, këtë po e dëshmojnë lëvizjet nëpër berëza. Dhe ky do të jetë një dëm i madh për qytetarët e Kosovës jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në atë social. Ndërsa në aspektin psikologjik, flet fakti se askush nuk e përmend tentativën për të investuar në kapacitete të reja prodhuese. Besoj se kjo është ndër problemet më të

mëdha që do ta rëndoj edhe më tepër qytetarin e Kosovës”, ka thënë ai për RTV Dukagjini. “Prandaj, të flitet për dëme qoftë në çmime, qoftë në konkurrencë, qoftë në aspektin e tregtisë ndërkombëtare, vërtet është utopike”, ka thënë Gërxhaliu. Gërxhaliu ka thënë se rritja e çmimit të energjisë do t'i rritë edhe çmimet e tjera të tregut. “Sot paralajmërohet se me këtë vendim [të ZRrE-së] një kilogram i bukës do të jetë nga 70 deri në 80 centë”, ka thënë ai. Zyra e Rregullatorit të Energjisë e Kosovës (ZRrE) më 16 prill ka miratuar tarifat e reja energjetike të cilat janë shtrenjtuar për 16.1 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Tarifat e reja do të hyjnë në fuqi më 1 maj. “Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka mbajtur seancën e katërt për vitin 2025. Në këtë seancë Bordi i ZRrE-së ka shqyrtuar dhe aprovuar tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të



transmetimit dhe tregut OST/OT, tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes OSSH dhe tarifat për Furnizuesin me Shërbim Universal FSHU. Këto tarifa për konsumatorët e rregulluar

tariforë janë llogaritur dhe dizajnuar ashtu që brenda vitit relevant, të hyrat që priten të mbliidhen nga këto tarifa do të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga Rregullatori, që

reflektojnë rritjen lineare të tarifave të rregulluara prej 16.1 % për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në kuadër të shërbimit universal. Këto tarifa do të hyjnë në fuqi nga 1 maj 2025. Tarifat me blloqe për konsumatorët shtëpiakë dhe tarifat ditë-natë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve do të përdoren për të nxitur konsumin eficient të energjisë elektrike”, ka njoftuar ZRrE. Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe ankesat e konsumatorëve dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Kundër shtrenjtimit të rrymës më 11 prill është mbajtur një protestë në Prishtinë, në ditën kur ZRRE-ja miratoi kërkesat e operatorëve për rritjen e tarifave. Shtrenjtimin e kanë kundërshtuar edhe përfaqësues të bizneseve, sipas të cilëve, kjo do të ndikojë në rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të tjera.

Reagim nga KMDLNj

ZRRE E MBYLLI QARKUN E KRIMIT EKONOMIK

Përkundër dy protestave në Prishtinë, kundërshtimit në forma tjera, dërgimit të komenteve, ndërmarrja e strukturuar kriminale ZRrE dje miratoi vendimin për rritje të çmimit të energjisë elektrike prej 16.1 për qind që në masë të madhe do ta vështirësojë jetën e pjesës dërmuese të qytetarëve të Kosovës, bizneseve të shumta e në veçanti shtresave të cënueshme siç janë: pensionistët, përfituesit e skemave sociale, veteranët e luftës etj. Qeveria Kurti 2 nuk ndërmori asnjë veprim për të mbrojtur qytetarin e varfëruar të Kosovës madje me disa improvizime të



ministres përkatëse pranoi rritjen duke përshkallëzuar këtë rritje. Ndërmarrja kriminale ZRrE asnjëherë nuk ka

përfaqësuar interesin e qytetarit por se ka mbrojtur në mënyrë skajshmërisht të pamoralshme interesin e

operatorëve të energjisë elektrike dhe strukturave të caktuara qeveritare, që nga përfundimi i luftës deri më sot. Për 15 vite ka vjedhur paratë e qytetarëve të Kosovës në baza etnike duke liruar serbët nga çdo detyrim për pagesë përmes fryrjes së faturave. As sot e kësaj dite qytetarët e dëmtuar nuk janë kompensuar ndonëse kemi një vendim të gjykatës. KMDLNj fton qytetarët të organizohen dhe t'i intensifikojnë protestat në mbrojtje të drejtave të tyre. ZRrE nuk është shteti dhe nuk mund të jetë mbi ligjin. Intensifikimi i protestave është në funksion të mbrojtjes së një

interesi të përgjithshëm prandaj duhet të protestojnë të gjithë pavarësisht përkatësisë etnike, bindjeve politike, moshës, gjinisë apo statusit në shoqëri. Rritja e çmimit të energjisë elektrike nuk do të mbetet rast i izoluar përkundrazi do të prodhojë rritje të çmimit të të gjithë artikujve dhe shërbimeve. Kjo rritje kriminale do të kontribuojë në shpopullim të Kosovës, edhe ashtu të rinjtë po ikin në mënyrë masive. Protestat duhen të organizohen në tërë Kosovën dhe KMDLNj fuqishëm përkrahë protesta të karakterit social dhe ekonomik.

Kurti riemëron Agron Llugaliun drejtor të përgjithshëm të Doganës

PRISHTINË, 17 PRILL - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim drejtorin e përgjithshëm të Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, të

cilin e ka riemëruar drejtor të Doganës me mandat katërvjeçar, sipas propozimit të ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve. Kryeministri në detyrë Kurti

dhe ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Trasnfereve, Hekuran Murati, falënderuan drejtorin Llugaliu për punën e deritanishme, e përgëzuan

për performancën e tij dhe të Doganës dhe e uruan për mandatin e ri duke i dëshiruar suksese të mëtejme në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tij.



JETA E CEZARËVE



Nga: Delphine STRAUSS
/ The Financial Times


Gjatë ngritjes së tij në pushtet, Jul Cezari nxitoi të siguronte për vete një mori të funksioneve publike, sepse kishte nevojë të fitonte imunitet nga ndjekja penale. Augusti, një kurator i kujdesshëm i imazhit të vet, mbathte sandale me taka për t'u dukur më i gjatë, ndërsa perandori jetëshkurtër, Otoni, mbulonte flokët e rëna me një paruke. Domiciani, i cili e tmerronte Senatin e Romës ndërsa përmbyste në paranojë, rrinte i vetëm dhe i thehte mizat me një penë të mprehur. Kështu të paktën na thotë Svetoni në veprën e tij skandaloze, por me detaje të përpikta, Jeta e cezarëve – shkruar në shekullin II pas Krishtit, kur ende qarkullonin thashethemet për veset personale, veprimet publike dhe devijimet private të 12 burrave që kishin mishëruar pushtetin perandorak përgjatë 150 vjetëve. Ka shumë jehonë bashkëkohore në këtë përkthim të ri nga historiani dhe podkasteri Tom Holland – botuar nga [Shtëpia Botuese] Penguin pikërisht tani kur burri i fortë i kohëve tona po

kthehet me vetëbesim në skenën politike amerikane, duke kërcënuar me shembje të kufijve kushtetues. Por, nëse cezarët e Svetonit na duken të njohur, kjo është kështu sepse – siç thotë vetë Holland – ai na dha “modelin se si duhet të shkruhet biografia e një sundimtari të madh”. Svetoni, një zyrtar me lidhje të fuqishme që shërbeu si sekretar privat i Adrianit, u mbështet në një shumëllojshmëri burimesh – letrat e shkruara me dorën e vetë Augustit të cilat ruheshin në arkiva, raportet publike nga provincat, kujtimet e babait të tij për shërbimin ushtarak nën Otonin, si dhe anekdotat e batutat që qarkullonin në opinionin publik. Ai nuk kishte për qëllim të jepte një rrëfim kronologjik të ngjarjeve. Përkundrazi, pasi përshkroi shkurtimisht prejardhjen familjare dhe karrierën, portretet e tij letrare janë të organizuara sipas temave – duke filluar nga cilësitë e admirueshme të çdo sundimtari, përpara se të kalonte te mangësitë e tyre; duke listuar ndërtimet publike dhe iniciativat legislative, por edhe preferencat seksuale, gladiatorët apo skuadrat e garave të preferuara, si dhe fallxhorët që

parashikonin ngritjen apo rënien e tyre nga pushteti. Rezultatet mund të jenë të habitshme: si ta bëjmë bashkë një Neron që financoi projekte ndërtimi të qëndrueshme ndaj zjarrit, me zjarrvënës in i cili këndonte ndërsa qyteti digjej? Apo Vitelion i cili lavdërohej si një administrator i ndershëm në provincë, me një servil të shthurur që shahej në Romë dhe i cili bënte gara me karroca me Kaligulën dhe shërbente gjuhë të flamingove në banketet që organizonte? Por, Jeta e cezarëve është e mbushur me detaje interesante dhe skena të paharrueshme. Ja ku është Augusti i cili merakoset për dorëshkrimin e nipërve të vet dhe që ua mëson notin. Ja Tiberi koprrac që shërben vetëm gjysmën e një derri të egër në një darkë. Dhe, ja Vespasiani modest që shpërthen në të qeshura kur dikush përpiqet t'ia bëjë qejfin duke ia lidhur prejardhjen me Herkulin. Dhe, ndonëse Svetoni ndonjëherë ndodhet përballë burimeve të kundërta që nuk mund t'i pajtojë, kur Jeta lexohet si një tërësi, ofron një tablo koherente dhe gjithëpërfshirëse se si autokracia lëshoi rrënjë në shtetin romak. Mbi të gjitha, libri flet për aspektin teatral që ishte e

nevojshëm për të ruajtur imazhin perandorak. Çdo cezar mund të gjykohej sipas përmasës dhe karakterit në gjueti, luftëra, gara dhe beteja detare që organizonte. Neroni mbante gara me qerre të tërhequra nga devet; Kaligula shkelte normat shoqërore duke luftuar vetë si gladiator; Domiciani e hodhi një spektator përpara qenve, vetëm sepse ai e bëri një koment. Por, i gjithë ky spektakël kërkonte para dhe mbështetje ushtarake. Cezarët vazhdimisht krijonin borxhe, duke zhvatur trashëgiminë dhe duke konfiskuar pronat e armiqve për të paguar shfaqjet, madhështinë dhe legjionet. Vespasiani – më pak aristokrat dhe më pak i pamëshirshëm se të tjerët – është i vetmi perandor që u konsiderua i padenjë ngaqë përfitoi nga tregtia, ndërsa godiste korrupsionin dhe rriti taksat, përfshirë edhe atë mbi urinën. Ndershmëria e tij u bë objekt talljeje. Në shumë prej këtyre aspekteve, bota e Svetonit është një botë të cilën mund ta njohim. Por, vlerat dhe dhuna e përhapur që përshkon veprën e tij, mund të na duken thellësisht të panjohura. Duken të tmerrshme helmimet dhe intrigat vrastare

që tronditnin familjet perandorake, si dhe përndjekjet që cezarët ndërmerrnin ndaj komplotistëve. Por, Svetoni lavdëron vendimet për të zbatuar disiplinën mes legjionarëve përmes decimationis [ekzekutimi i një në dhjetë ushtarëve në një grup ushtarak, për shkelje të ndonjë rregulli], apo për të ndëshkuar një virgjëreshë vestale [priftëreshë e kultit të perëndeshës Vesta], që kishte thyer betimin, duke e varrosur për së gjalli – sipas zakonit të lashtë. Otoni e kishte shlyer veten, në fund, përmes një vetëvrasjeje që ka të bëjë me një vendimmarrje. Degjenerimi i Neronit paraqitet qartë përmes frikës dhe hezitimit të tij për t'ia prerë vetes fytyrën. Megjithatë, pas vdekjes së Neronit, që e zhyti sërish perandorinë në trazira të reja, shumica e romakëve duket se ishin ngopur me dhunën. Vitelio, që ecte mbi një fushëbetejë të mbushur me gjak, i neveriti shokët e vet kur tha se një armik i vdekur “kishte një erë të këndshme”. Argumenti kryesor për emërimin e një perandori të ri ishte i qartë: një cezar mizor dhe i paqëndrueshëm ishte më i pranueshëm se lufta civile. /Telegrafi/



Khaka: Babai është kritiku im më i madh

Granit Xhaka, një nga emrat më të spikatur me origjinë shqiptare në futbollin evropian, po përjeton një sezon fantastik me Bayer Leverkusenin. Së fundmi, mesfushori ka dhënë një intervistë ndryshe për të

përditshmen gjermane “Bild”, ku ka folur për jetën jashtë fushës dhe raportin me familjen. “Babai është kritiku im më i madh. Asnjëherë nuk më ka lavdëruar si futbollist”, u shpreh Xhaka, duke zbuluar një anë më personale

të jetës së tij. Ai tregoi se pas çdo ndeshje e analizon me qetësi performancën e tij. “E shikoj çdo ndeshje që përfundon dhe e analizoj me qetësi. Kuptoj çfarë ka ndodhur dhe pse ka ndodhur. Kjo më ndihmon të

përmirësohem. Jam ende ai djaloshi 19-vjeçar që erdhi në Bundesliga, emocional dhe me pasion, njësoj si në kohën kur isha te Borussia Monchengladbachu”, ka shtuar lojtari me origjinë shqiptare.



Nuk gabojnë Drita dhe Ballkani



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 PRILL - Dy skuadrat e para në renditjen tabelore të Superligës së Kosovës në futboll, Drita dhe Ballkani, kanë shënuar fitore të enjten ndaj Prishtinës, përkatësisht Gjilanit. Skuadra lidere, Dita, e mposhti më lehtë se që është pritur Prishtinën me rezultat 2-0. Dy golat e fitores vendasit i shënuan në pjesën e parë me anë të Tushës. Në pjesën e dytë, Dita shënoi edhe golin e tretë, i cili më pas u anulua. Pas këtyre tri pikëve gjilanasit përforcohen në pozitën e parë me 63 pikë, kurse Prishtina vazhdon të jetë në vendin e pestë me 38 pikë. Fitore ka shënuar edhe Ballkani në përballje me Gjilanin me rezultat 1-0. Edhe në këtë ndeshje goli i vetëm u shënuar në

pjesën e parë. Autor ishte sulmuesi në formë të mirë Sunday Adetunji. Ballkani me tri pikët e reja shkon në kuotën e 53 pikëve, 10 pikë më pak se skuadra kryesuese, derisa Gjilani zë vendin e gjashtë me 38

SUPERLIGA		
Drita - Prishtina		2-0
Ballkani - Gjilani		1-0
Ferizaj - Malisheva		1-0
Llapi - Feronikeli		1-0
Dukagjini - Suhareka		1-1
Tabela		Pikë
1. Drita		63
2. Ballkani		53
3. Malisheva		47
4. Ferizaj		41
5. Prishtina		38
6. Gjilani		38
7. Llapi		36
8. Dukagjini		36
9. Suhareka		33
10. Feronikeli '74		14

pikë. Të mërkurën Llapi dhe Ferizaj kanë regjistruar fitore të rëndësishme, duke vazhduar kështu ecurinë pozitive në këtë fazë vendimtare të edicionit. Llapi ka shënuar fitoren e tretë radhazi në të gjitha garat, duke e mposhtur Feronikelin 74, me rezultat minimal 1-0 në stadiumin “Zahir Pajaziti”. Golin e vetëm të takimit e realizoi qendërsulmuesi Ardit Tahiri nga pika e bardhë në minutën e 45-të, duke i dhënë tre pikë të arta skuadrës së drejtuar nga Tahir Batatina. Një fitore të rëndësishme e ka regjistruar edhe skuadra e Ferizajt, e cila në shtëpi mposhti Malishevën, po ashtu, me rezultat 1:0, duke shënuar kështu fitoren e dytë rresht në Superligë. Golin e vetëm të ndeshjes e realizoi mesfushori Edon Sadriu në minutën e 39.

SHKURT

Kosova i mbyll kualifikimet për ‘Euro 2026’ me fitore në Bullgari

Përfaqësuesja e Kosovës e ka përmbyllur me fitore ciklin e kualifikimeve për “Euro 2026”, teksa si mysafire e mposhti Bullgarinë me rezultat 4:3 në kuadër të Grupit 10. Me këtë fitore, Kosova e mbylli ciklin kualifikues në pozitën e tretë të grupit me 6 pikë, më shumë se çdo përfaqësuese tjetër nga rajoni. Grupin e fitoi Franca, ndërsa Gjeorgjia zuri vendin e dytë.

Fitore bindëse për Istogun e Ferizajn

Skuadrat e kreut, Istogu e Ferizaj, nuk kanë hasur në telashe për t’i fituar ndeshjet e xhiros së 17-të të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Lideri, Istogu, fitoi në Obiliq ndaj Terezës me rezultatin 43:29. Motrat Suzana e Dijana Ujkiq ishin më efikasat tek Istogu me nga 13 gola. Gjashtë i realizoi Lana Paviçević. Te Tereza, Kaltrina Paci i shënoi tetë gola. Shtatë i kishte Arjeta Imeraj e gjashtë Melike Ipçi. Fitore edhe më të thellë shënoi Ferizaj. Në kryeqytet, ferizajaset fituan 47:17 ndaj Prishtinës. Luljeta Sopjani u shqua me 13 gola te Ferizaj. Dhjetë i shënoi Salemateu Camara e nëntë Elsa Kongjeli. Angelika Luberecka dhe Era Shaljani shënuan nga pesë gola për Prishtinën.

Arsenali është favorit për të fituar Ligën e Kampionëve

Edhe pse festat pas kualifikimeve nuk janë shuar ende, skuadrat gjysmëfinaliste të Ligës së Kampionëve tashmë synojnë të sigurojnë një vend për në finalen e 31 majit në Munchen. Pas eliminimit të disa prej pretendentëve kryesorë si Real Madrid dhe Bayern Munich, ka ndryshuar edhe renditja e favoritëve për trofeun. Arsenali ka kaluar në krye të listës me 28.7 % shanse për ta fituar Ligën e Kampionëve, i ndjekur nga Interi me 25.5 %. Paris Saint-Germaini ruan vendin e tretë, ndërsa Barcelona ka zbritur në vendin e katërt sipas kuotave aktuale. Gjithçka është gati për një finale të madhe në Munchen. Mbetet të shihet se cilat dy skuadra do ta fitojnë biletën për 31 maj.

Përcaktohen gjysmëfinalistët për turneun final të Kupës në Hendboll

PRISHTINË, 17 PRILL - Të enjten është tërhequr shorti për gjysmëfinalen e Kupës së Republikës së Kosovës në të dyja konkurrencat. Turneu final i Kupës mbahet në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj më 26 e 27 prill. Gjysmëfinalja e parë e Kupës vë përballë fituesin në fuqi, Kastriotin, dhe kampionin në fuqi, Rahovecin. Ndeshja e

fundit mes këtyre dy skuadrave përfundoi baras. Në gjysmëfinalen e dytë përballen Vushtrria e Besa Famgasi. Skuadra pejane llogaritet favorite e madhe për vend në finale. Ndeshje interesante në gjysmëfinale do të zhvillohen edhe në konkurrencën e femrave. Turneun final të

Kupës e organizojnë KH Kastrioti dhe KHF Ferizaj. Te hendbollistet, të dyja ndeshjet vlerësohen shumë interesante. Gjysmëfinalja e parë vë përballë Samadrexhën e Ferizajn, ndërsa në të dytën takohen Istogu dhe Vushtrria. Të gjitha skuadrat kanë pretendimet për ta fituar trofeun e çmuar të Kupës.



Van Dijk vazhdon kontratën me Liverpoolin

Liverpool, 17 prill - Kapiteni i Liverpoolit, Virgil van Dijk, ka përkushtuar të ardhmen e tij në klub duke nënshkruar një kontratë të re që do ta shohë atë të qëndrojë në "Anfield" përtej sezonit 2024/25. Pas Mohamed Salah, "Reds" ka rinovuar kontratën edhe me

yllin tjetër të skuadrës, Van Dijk. Njoftimi i Liverpoolit ka ardhur me anë të faqes zyrtare, ku ka njoftuar se mbrojtësi holandez ka nënshkruar edhe për dy vjet të tjera. "Virgil van Dijk ka nënshkruar sot një kontratë të re me Liverpool FC për ta zgjatur kohën e tij me

klubin përtej sezonit 2024-25". Kjo marrëveshje e re zgjat mandatin e mbrojtësit holandez me "Reds", duke shënuar gati shtatë vjet e gjysmë që nga ardhja e tij në janar 2018. Që kur u bashkua nga Southamptoni, Van Dijk u ka vendosur veten si një nga

mbrojtësit më të mirë në botë, duke kontribuar në shtatë trofe të mëdhenj, duke përfshirë Ligën Premierë, Ligën e Kampionëve, Kupën FA dhe dy Kupa të Ligës. Me 314 paraqitje dhe 27 gola, Van Dijk vazhdon të jetë një figurë kryesore në skuadër.



Ancelotti: Arsenali e meritoi kualifikimin, duhet të luftojmë për trofetë e tjerë

MADRID, 17 PRILL - Real Madridi është eliminuar nga Liga e Kampionëve. Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se pas këtij zhgënjimi skuadra duhet të ringrehet dhe të luftojë për La Liga, Kupën e Mbretit dhe Kupën e Botës për klube. "Tani jemi në garë për La Ligën, kemi përpara finalen e Kupës së Mbretit, Kupën e Botës për Klube... Është një sezon i pafund, por duhet të ngrihemi sërish. Është një pjesë tjetër e futbollit të cilën nuk jemi mësuar ta përfjetojmë. E ardhmja ime? Nuk e di çfarë do të ndodhë dhe nuk dua ta di", ka thënë Ancelotti, i cili e ka pranuar se skuadra e Arsenalit e ka merituar kualifikimin në gjysmëfinale. "E zhvilluam mirë ndeshjen, pati shumë ndërprerje. Na duhej një moment ndezjeje. Ajo penallti që nuk na u dha mund të ishte ky moment. Sidoqoftë, Arsenali e meritoi kalimin e raundit. E provuam, por ta rikuperonim rezultatin 3-0



ishte e vështirë. Arsenali ishte shumë mirë i organizuar. Duhet ta pranojmë edhe anën e trishtuar të futbollit, sepse sezoni vazhdon. Në këtë kompeticion kemi pasur shumë kënaqësi, por këtë vit nuk shkoj mirë. Rruga deri këtu ishte e vështirë, në çerekfinale patëm përballë një skuadër që ishte më e mirë se ne", ka shtuar Ancelotti.

Për të ardhmen e tij ka nisur të flitet shumë, derisa strategu italian e ka konfirmuar se nuk ka asgjë të re. "Asgjë e re. Të dielën kemi një tjetër ndeshje, pas 10 ditësh finalen e Kupës së Mbretit, në verë Kupën e Botës për Klube dhe jemi ende në garë për kampionatin. Kam shumë gjëra për të menduar, më tepër se për këto hollësi", ka përfunduar Ancelotti.

Dëshmi tronditëse në gjyqin për vdekjen e Maradonës: Dhoma kundërmonte erë urinë

BUENOS AIRES, 17 PRILL - Gjyqi për vdekjen e legjendës së futbollit, Diego Armando Maradona, ka hyrë në një fazë të re emocionale dhe të rëndë pas një dëshmie të fuqishme nga vajza e tij, Dalma Maradona. Shtatë punonjës shëndetësorë janë nën akuzë për neglizhencë mjekësore në lidhje me vdekjen e ikonës argentinase, por deklarata e Dalmas ka ndezur edhe më tej debatin publik mbi trajtimin që iu bë ish-futbollistit në ditët e fundit të jetës së tij. Në një dëshmi të dhënë të martën, Dalma përshkroi gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhej Maradona. "Dhoma ku ishte babai im ishte e neveritshme: kundërmonte era urinë, asnjë qenie njerëzore nuk duhej të ishte në një vend të tillë, aq më pak babai im në



ato kushte shëndetësore", u shpreh Dalma. Ajo e akuzoi ekipin mjekësor për mashtrim dhe manipulim emocional: "Na premtuan një shtrim në shtëpi që nuk ndodhi kurrë. Na bënë të besojmë në diçka që nuk ekzistonte. Ne u mashtruar në mënyrën më mizore, vetëm për ta mbështetur atë gënjeshtër".

Procesi gjyqësor do të vazhdojë në javët e ardhshme, ndërsa ende nuk është e qartë se si do të përfundojë çështja. Megjithatë, dëshmia prekëse dhe e drejtpërdrejtë e vajzës së Maradonës ka hedhur edhe më shumë hije mbi mënyrën si u trajtua legjenda e futbollit në çastet e tij më të vështira.

SHKURT

Miami dhe Dallasi kalojnë më tej, përcaktohen finalistët e fazës 'play-in'

Të mërkurën në mbrëmje janë zhvilluar edhe dy ndeshjet e radhës së fazës "play-in" në NBA, që do t'i përcaktojnë skuadrat e fundit çerekfinaliste. Në Konferencën e Lindjes, ekipi i Miamit fitoi me rezultat 109-90 në fushën e Chicagos. Ndeshje e komanduar nga miqtë, ku u dallua Tyler Herro, protagonist me 38 pikë. Në ndeshjen e fundit të kësaj faze në këtë Konferencë, Miami do të luajë ndaj Atlantës. Në Konferencën e Perëndimit skuadra e Dallasit mundi me shifrat 120-106 Sacramenton, në një duel pa shumë histori. Anthony Davis me 27 pikë e Klay Thompson me 23 pikë u dalluan për miqtë. Në sfidën që do ta përcaktojë ekipin e fundit çerekfinalist në Perëndim, ekipi i Dallasit do të luajë ndaj Memphisit.

Kompany: Nuk bëmë mjaftueshëm në këto dy ndeshje

Trajneri i Bayern Munchenit, Vincent Kompany, e ka pranuar se skuadra nuk ka bërë sa duhet për ta arritur kualifikimin në gjysmëfinale. Bayerni ndeshjen e parë e humbi nga Interi si vendas 1-2, kurse në ndeshjen e dytë luajti baras me rezultat 2-2 në ndeshjen kthyesë në Itali. "Kam emocione miske, por realiteti është që nuk do të kemi shanse të luajmë në finalen e Munchenit. Jemi të vetëdijshëm se nuk bëmë mjaftueshëm në këto dy ndeshje. Fakt është, gjithashtu, që dëmtimet u kthyen në temë kryesore, por pavarësisht këtij fakti në të dy ndeshjet treguam një Bayern të mirë. Me vjen keq për këtë rezultat", ka deklaruar Kompany.

Arteta: Gjysmëfinale historike, nuk ishte e lehtë të luanim në 'Bernabeu'

Pas fitores 2-1 ndaj Real Madridit dhe arritjes në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve, trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka thënë se janë të lumtur me suksesin e arritur. Strategu spanjoll e ka pranuar se nuk ishte lehtë të luanim në Madrid. "Jemi shumë të lumtur. Kjo është gjysmëfinalja e tretë në historinë e klubit tonë. Për mënyrën si erdhi, është një arritje shumë e rëndësishme. Nuk ishte e lehtë të luanim në Madrid, por ia dolëm edhe në aspektin mendor dhe emocional. Pas 16 vjetësh, kualifikimi në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve është një sukses i madh", ka thënë Arteta, i cili foli edhe për kundërshtarin e radhës, PSG-në. "PSG-ja është në formën më të mirë në Evropë për momentin, por ne jemi shumë të lumtur që do të luajmë kundër saj", ka deklaruar Arteta.

Te Red Bulli tremben nga klauzolat e Verstappenit, kampioni i botës mund t'i bashkohet Mercedesit

E ardhmja e Max Verstappenit te Red Bulli, edhe pse ka një kontratë deri në vitin 2027, mund të ndërpritet në fund të këtij sezoni. Kjo gjë mund të ndodhë për shkak të një klauzole që katër herë kampioni i botës në Formula 1 ka me makinën austriake. Në

fakt, në kontratë ka disa klauzola, por një e tillë në favor të pilotit mund të bëjë që ai të shkojë në një skuadër tjetër. Kështu, është zbuluar se në rast se Verstappeni renditet i katërti në korrik, ai mund t'i nisë negociatat me skuadrat e tjera. Sipas "F1 Insider",

mësohet se "klani Verstappen" është gati të negociojë me Mercedesin, por me kusht që të jetë makina gjermane ajo që duhet ta bëjë lëvizjen e parë. Pra, është në dorën e "Shigjetave të Argjendta" për të demonstruar se sa e rëndësishme do të ishte për ta

që të punësonin Verstappenin. Një tjetër skuadër e interesuar duket se është Aston Martin, ku këtë vit po punon Adrian Newey, njeriu që bëri Red Bullin një makinë të pathyeshme gjatë tri viteve që Verstappenin u shpall kampion bote për pilotë. Gjithçka

do të varet nga pozicioni që do të ketë në renditje piloti holandez në korrik kur edhe nisin pushimet verore. Aktualisht Verstappenin është i treti me 69 pikë pas dy pilotëve të McLarenit dhe vetëm 6 pikë më shumë se Russell (i katërti).



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Izabel Lekaj shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Nikë Deda shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Dijon Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Valentini Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhde e Hasit.
- Jeton Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhde e Hasit.
- Sadije Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- Venera Qollaku shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Luciano Motroni" Prizren.
- Alnor Boshnjaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Saime Muhaxhiri B.I. nga Gjakova të numrit fiskal 810246331 të lëshuar nga ARBK.
- Shpresa Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Damjan Gjakovë. Nga kl 1-8
- Fatlinda Fazlija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Resmije Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 400 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

